



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Shtojca 13.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT

Data 21.08.2026

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE): AEG-Consulting, NUIS M56521401U, me përqindje: 20%, adresa Diber Bulqize Rruga e Spitalit;Nd.1, H. 1, App.1,, Lagjia e Vjeter, Bulqizë & ARENA MK, NUIS L67619801Q, me përqindje: 80%, adresa Fier Ballsh Fshati Ninësh; Rruga Dames - Ninesh; Ndertesa 4; Lagja Memaj; Nj.Adm.Fratar; Bashkia Mallakaster 9328.

Operatorit Ekonomik (OE) ☐ ose

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☒

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) AEG-Consulting, NUIS M56521401U, me përqindje: 20%, adresa Diber Bulqize Rruga e Spitalit;Nd.1, H. 1, App.1,, Lagjia e Vjeter, Bulqizë & ARENA MK, NUIS L67619801Q, me përqindje: 80%, adresa Fier Ballsh Fshati Ninësh; Rruga Dames -Ninesh; Ndertesa 4; Lagja Memaj; Nj.Adm.Fratar; Bashkia Mallakaster 9328.

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Sherbime

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-89050-06-06-2026. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Studim Projektim rruga Krumë - Cahan - Pogaj, Gjatësi 16.44 km, afati për zbatimin e saj: 1 muaj [Objekti, sasi të dhe kohëzgjatja e kontratës]

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 13.08.2026.

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit Buletini Nr. 52 datë 17 Gusht 2026 [Data] [Numri]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto **X**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. NET-GROUP

L72023002P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **12,950,230** (Dymbedhjetë milion e nentëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë) Leke pa t.v.sh. **totali i pikëve të marra [0]**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

2. BOE C.E.C GROUP & MF INVEST GROUP

L11807013M / L71830010R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **12,960,000** (*Dymbedhjetë milion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë*) Leke pa t.v.sh. **totali i pikëve të marra [0]**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. BOE AEG-Consulting & ARENA MK

M56521401U / L67619801Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **12,788,646.22** (*Dymbedhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzete e gjashtë pike njetete e dy*) Leke pa t.v.sh. **totali i pikëve të marra [300]**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Gjeokonsult & CO

K91810005U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **11,951,195.96** (*Njembedhjetë milion e nentëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e nentëdhjetë e pesë pike nentëdhjetë e gjashtë*) Leke pa t.v.sh. **totali i pikëve të marra [0]**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

1. NET-GROUP

L72023002P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **12,950,230** (Dymbëdhjetë milion e nentëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë) Leke pa t.v.sh.
totali i pikëve të marra [0] (e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

Se pari, shoqëria “NET-GROUP” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht pika 2.3.2 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi; Ing. E S rezulton drejtues teknik i siguar me 15 dite pune ne muaj per periudhen e kerkuar ne kerkusat per kualifikim, ne kundershtim me dispozitat ligjore ne fuqi, qe kerkon drejtuesit teknik te jene te punesuar me kohe te plote.

1 (nje) Inxhinier Gjeodet /topograf/markshajder Ing. M F. Ing. Sh C rezulton drejtues teknik i siguar me 7 dite pune ne muaj per periudhen e kerkuar ne kerkusat per kualifikim, ne kundershtim me dispozitat ligjore ne fuqi, qe kerkon drejtuesit teknik te jene te punesuar me kohe te plote.

1 (nje) Inxhinier Elektrik Ing. B D rezulton drejtues teknik i siguar me 8 dite pune ne muaj per periudhen e kerkuar ne kerkusat per kualifikim, ne kundershtim me dispozitat ligjore ne fuqi, qe kerkon drejtuesit teknik te jene te punesuar me kohe te plote.

Se dyti, shoqëria “NET-GROUP” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht pika Operatori ekonomik ofertues nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te

nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Nga vlerësimi i ofertës ekonomike të këtij operatori rezulton se nuk është llogaritur në perputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" duke qënë se oferta ekonomike është mbi kufirin maksimal të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kesaj VKM, kërkesë kjo e cila bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 "Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.

2. BOE C.E.C GROUP & MF INVEST GROUP

L11807013M / L71830010R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **12,960,000** (*Dymbëdhjetë milion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë*) Leke pa t.v.sh. **totali i pikëve të marra [0]**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si me poshte:

Se pari, BOE "C.E.C Group" & "MF Invest Group" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 1.a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Shoqëria "MF Invest Group" sh.p.k. ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca 10 në format dhe përmbajtje të ndryshme nga ajo që është miratuar nga APP dhe të publikuar nga autoriteti kontraktor në DST për këtë procedurë prokurimi.

Se dyti, BOE "C.E.C Group" & "MF Invest Group" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023,2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balancet, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Shoqëria “MF Invest Group” sh.p.k. nuk ka paraqitur raport nga eksperti kontabel për Bilanci 2024.

Se treti, BOE “C.E.C Group” & “MF Invest Group” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.2 *Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si më poshtë:*

1 (nje) Inxhinier Ndertimi;

1 (nje) Inxhinier Gjeodet /topograf/markshajder

1 (nje) Inxhinier Elektrik

Per stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë, CV .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 5).

Shënim: *Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: *Operatorët ekonomik te kualifikuar duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

Asnjëri nga anetaret e bashkimit të operatoreve ekonomik nuk ka paraqitur deklarate nga stafi i propozuar për këtë procedure prokurimi mbi disponueshmërinë për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 5).

Se katerti, BOE “C.E.C Group” & “MF Invest Group” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.3 *Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre stafin mbështetës (jo domosdoshmerisht ne licencën e shoqërisë si drejtues teknik) dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për te pakten muajin e fundit :*

1 (nje) Inxhinier ndertimi profili infrastrukture/transport/rruga-ura etj

Per stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale ne projektim, Çertifikate/Diplomë, CV.

Per stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë, CV.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shoqëria “MF Invest Group” sh.p.k. ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojca 10 nuk ka percaktuar emrin e inxhinierit te propozuar per kete procedure prokurimi per plotesimin e kriterit per disponimin e 1 (nje) Inxhinier ndertimi profili infrastrukture/transport/rruga-ura etj.

Shoqëria “C.E.C Group” sh.p.k. ka marr përsiper 95% të përfaqësimit dhe nuk ploteson kriterin për disponimin e 1 (nje) Inxhinier ndertimi profili infrastrukture/transport/rruga-ura etj. Pra, nuk është bërë drejtdarja e përqindjes së përfaqësimit për secilin anetar të BOE.

Se pesti, BOE “C.E.C Group” & “MF Invest Group” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën **7 (shtatë)** personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar si dhe listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Shoqëria “C.E.C Group” sh.p.k. ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojca 10 nuk ka percaktuar numrin e punonjesve qe disponon per secilin muaj te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor ne kërkesat e vecanta per kualifikim.

Shoqëria “MF Invest Group” sh.p.k. ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojca 10 nuk ka percaktuar numrin e punonjesve qe disponon per secilin muaj te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor ne kërkesat e vecanta per kualifikim.

Se gjashti, BOE “C.E.C Group” & “MF Invest Group” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.6 *Operatori ekonomik ofertes duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme ose ekuivalentet e tyre per objektin e prokurimit si me poshte:*

- a. *Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/UNI 9001:2015 ose ekuivalente.*

- b. *Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/UNI 14001-2015 ose ekuivalente.*
- c. *Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor SSH/DIN/EN/UNI 39001-2012 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/UNI 39001-2012 ose ekuivalente.*

Asnjëri nga anëtarët e BOE nuk kanë bërë mirembajtjen vjetore të certifikatave Iso sa më sipër.

Se shtati, BOE “C.E.C Group” & “MF Invest Group” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.
- 1(një) Pajisje dron për fotogrametri dhe matjet
- 1(një) Automjet

Për plotësimin e kësaj kërkeje duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shoqëria “MF Invest Group” sh.p.k. nuk ka përcaktuar të dhenat e automjetit që disponon të tilla si targa, shasia, leja e qarkullimit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcë 10.

Se teti, BOE “C.E.C Group” & “MF Invest Group” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

-1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".*

AQSCERT nuk është i akredituar për leshimin e certifikatave sa më sipër.

-1 (një) punonjes i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”).

P J është propozuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” por nuk ka deklaruar certifikatën e kualifikimit / titull diplome si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

Operatori ekonomik ofertues nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Nga vlerësimi i ofertës ekonomike të këtij operatori rezulton se nuk është llogaritur në përputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” duke qënë se oferta ekonomike është mbi kufirin maksimal të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kësaj VKM, kërkesë kjo e cila bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.

Operatorët ekonomik, në përmbushje të pikës 4.4, germa A) duhet të paraqesin (i) *Përvoja për Punë të Ngjashme të Operatorit Ekonomik*, (ii) *Metodologjia e Propozuar*, (iii) *Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar* për qëllim të vlerësimit me pike të propozimit teknik.

Metodologjia e propozuar ka parashikuar për vepra në fushën e ujësjelles kanalizime, në kundërshtim me detyrën e projektimit. Metodologjia është hartuar vetëm në emër të kompanisë C.E.C. Group shpk dhe jo në emër të bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Deklarata e paraqitur nga O Z përfaqësues i operatorit ekonomik “MF Invest Group” sh.p.k. ka referuar datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit 29.10.2026. Në fakt procedura e prokurimit është zhvilluar në Muajin Qershor 2026.

Shoqëria “MF Invest Group” sh.p.k. ka marrë për shprehje plotësimin e kriterit për disponimin e stafit 1 (një) Inxhinier ndërtimi profili infrastrukturë/transport/rruga-ura etj. Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, shoqëria “MF Invest Group” sh.p.k. ka marrë për shprehje vetëm 5% të përfaqësimit, por nuk është bërë e saktë ndarja e përqindjes së përfaqësimit pasi minimumi i përfaqësimit duhet të ishte jo më pak se 14.28%.

Shtojca 1 është plotësuar për referencën e punimeve REF-89050-096-06-2026. Procedura e prokurimit objekt shqyrtimi ka referencë tjetër, të ndryshme nga ajo që referon ofertuesi.

3. Gjeokonsult & CO

K91810005U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **11,951,195.96** (*Njembdhjetë milion e nentëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e nentëdhjetë e pesë pike nentëdhjetë e gjashtë*) Leke pa t.v.sh. **totali i pikëve të marra [0]**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

Se pari, shoqëria “Gjeokonsult&Co” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.2 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndertimi;

1 (një) Inxhinier Gjeodet /topograf/markshajder

1 (një) Inxhinier Elektrik

Ka mosperputhje të nivelit të pagave të deklaruara në listat e tabelave me tabelën për pagën indikative të profesioneve.

Se dyti, shoqëria “Gjeokonsult&Co” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e pikës 2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të pershtatshme **ose ekuivalente** **tyre** për objektin e prokurimit si më poshtë:

- a. Certifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI 9001:2015 ose ekuivalente.
- b. Certifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e

Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI 14001-2015 ose ekuivalente.

- c. Certifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor SSH/DIN/EN/UNI 39001-2012 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI 39001-2012 ose ekuivalente.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, nëpërputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Nuk plotëson kriterin sa me sipër.

Se treti, shoqëria "Gjeokonsult&Co" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, pika 2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

-1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".*

1 (nje) Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne pune – L T, eksperte HSE, Inxhiniere Gjeodete me kontrate date 01.02.2021, diplome me titull Inxhiniere Gjeodete, master Profesional date 18.02.2014 , nr.MP-107 leshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës , Fakulteti i Inxhinierise se ndertimit dhe certifikate per :Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” nr. AQS/T/S31262018 leshuar nga kompania e certifikime QASCERT

AQSCERT nuk është i akredituar për leshimin e certifikatave sa me sipër. Për me teper certifikata AQS/T/S31262018 leshuar nga kompania e certifikimeve AQSCERT ka perfunduar me date 25.10.2019, date e cila është parashikuar për rilesimin e saj nga organi qe e ka leshuar heren e pare.

-1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").

1 (nje) Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave – Xh M, Inxhinier Gjeodet , kontrate date 01.02.2021 , diplome titull Inxhinier Gjeodet nr 3800 leshuar nga Fakulteti i Inxhinirise se Ndertimit

. dega gjeodezi dhe certificate per :Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave me nr AQS/T/ S31252018

AQSCERT nuk eshte i akredituar per leshimin e certifikatave sa me siper.

Se katerti, shoqëria “Gjeokonsult&Co” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, Operatorët ekonomik, ne permbushje te pikes 4.4, germa A) duhet te paraqesin (i) *Përvoja per Punë të Ngjashme të Operatorit Ekonomik*, (ii) *Metodologjia e Propozuar*, (iii) *Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar* per qellim te vleresimit me pike te propozimit teknik.

Metodologjia e propozuar nga operatori ekonomik ka parashikuar ne faqe 28:

KOHEZGJATJA DHE DOREZIMI I PRODUKTEVE

*Kohezgjatja, Kohëzgjatja e shërbimeve do të jetë **14 – Jave kalendarike nga data e nenshkrimit te kontrates dhe fillimit.***

Dorëzimi dokumentacionit teknik dhe afatet Dokumentat qe duhen dorezuar ne nje afat prej 6 -Muaj jane:

o Dokumentacioni

o Numri i kopjeve

o Afati

o Kopje te printuara

o CD

Pra, operatori ekonomik propozon afatin prej 6 muaj per dorezimin e dokumentacionit.

Autoriteti kontraktor ne ftesen per oferte ka percaktuar afatin per realizimin e ketij objekti 1 muaj. Gjithashtu, operatori ekonomik ka paraqitur grafikun per realizimin e objektit per afatin prej 14 jave. Pra, ka tejkualuar afatin e parashikuar nga autoriteti kontraktor per realizimin e ketij objekti.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE AEG-Consulting**, NUIS M56521401U, me **përqindje: 20%**, adresa Diber Bulqize Rruga e Spitalit;Nd.1, H. 1, App.1, Lagjia e Vjeter, Bulqizë & **ARENA MK**, NUIS L67619801Q, me **përqindje: 80%**, adresa Fier Ballsh Fshati Ninësh; Rruga Dames - Ninesh; Nderresa 4; Lagja Memaj; Nj.Adm.Fratar; Bashkia Mallakaster 9328 [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **12,788,646.22** (Dymbedhete milion e shtateqind e tetedhete e tete mije e gjashteqind e dyzete e gjashte pike njezete e dy) Leke pa t.v.sh. **totali i pikëve të marra [300]** [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]